




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 4599 Prot

Tiranë, më 12.11.2019

Nr.123 Dosje

URDHËR

PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E RREGJISTRIMIT

TIRANË

Unë, Julian Ahmeti, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat “E.P.S.A” SHPK, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 916 Akti., të lëshuar me Datë 15.05.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 123, Datë 11.10.2019 kërkesën e kreditorit “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore” ndaj debitorit Shoqëria “Guri i Bardhe” SHPK, “Mase Administrative Nr. 3152 date 17.03.2015”

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 916 Akti., të lëshuar me Datë 15.05.2019 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitorët Shoqëria “Guri i Bardhe” SHPK kanë marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorëve në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në kushtet kur mospëmbushja në referim të nenit 527, 560, 563 të K.Pr.Civile dhe nenit 32 pikat (b,c,ç) të ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

KËRKOJ

1- Qendra Kombëtare e Rregjistrimit Tiranë, brenda 10-ditësh nga marrja dijeni, të kryejë veprimet për bllokimin e kuotave/aksioneve dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për debitorët ;

- Shoqëria "Guri i Bardhe" SHPK me NIPT: K130010110.

të lartëpërmendur, deri në një urdhër të dytë nga përmbaruesi gjyqësor.

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

## SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "E.P.S.A" SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

**JULIAN AHMETI**

